

UDHËZIM
Nr. 29, datë 10.9.2014

PËR PROCEDURËN E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, PËR SHTETASIT E HUAJ QË KËRKOJNË TË STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2014-2015

Në mbështetje të nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 1 ç dhe pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 517, datë 1.8.2014 “Për kuotat e pranimit të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jo-universitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2014-2015”,

UDHËZOJ:

1. Studentët e huaj që aplikojnë individualisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit apo në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, për ndjekjen e studimeve në ciklin e parë të studimeve, për vitin akademik 2014-2015, të përzgjidhen për programin e studimit të kërkuar, në bazë të dosjeve të aplikantëve të përcjella individualisht nga vetë të interesuarit ose të ardhura nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, nga ministritë e arsimit të vendeve përkatëse ose nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

2. Studentët e huaj duhet të paraqesin në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në periudhën 10 shtator 2014 - 1 tetor 2014 dokumentet e mëposhtme:

- a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi;
- b) Vërtetim që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, në vendin e origjinës, i lëshuar 3 muajt e fundit;
- c) Fotokopjen e njësuar të dokumentit personal të identitetit;
- d) Fotokopjen e njësuar të origjinalit të legalizuar të diplomës së shkollës së mesme e shoqëruar nga një dokument të lëshuar nga autoritetet arsimore kompetente që dëshmon se mbajtësi i diplomës ka të drejtë të ndjekë studimet në institucione të arsimit të lartë në vendin e tij/saj;
- e) Certifikatë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë së Universitetit të Tiranës, dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument që provon njohjen e gjuhës shqipe në nivelin e kërkuar (për shembull, diplomë e kryerjes së një cikli studimi në gjuhën shqipe, etj.);
- f) Kopjen e njësuar të origjinalit të leje qëndrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme, nëse disponohet nga aplikuesi;
- g) Curriculum Vitae;
- h) Deklaratë sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni paraqet mangësi, Drejtoria e Integritit dhe Projekteve i kërkon aplikantit plotësimin e tij brenda datës 1 tetor 2014. Drejtoria e Integritit dhe Projekteve dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, shqyrtojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe, në rastet kur numri i kërkesave është më i lartë se ai i kuotave të miratuara për shtetasit e huaj për ciklin përkatës të studimit, bëjnë renditjen e kandidatëve sipas kriterit të meritës dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit përkatës, bazuar dhe në kapacitetet pritëse të IAL-ve. Kërkesat e aplikantëve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të plotë, sipas specifikimeve në këtë udhëzim brenda afateve të parashikuara, nuk do

të merren në shqyrtim.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit i dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda datës 3 tetor 2014, dokumentacionin përkatës të aplikantëve të përzgjedhur sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, për të kryer procedurat e mëtejshme të regjistrimit në programet e studimit përkatës.

5. Shtetasit e huaj brenda datës 17 tetor 2014 paraqiten pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse për të përfunduar procedurat e regjistrimit në programin përkatës të studimit.

6. Brenda datës 3 nëntor 2014 institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për shtetasit e huaj, për çdo program studimi, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45 datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të ndryshuar. AKP përgatit dhe i përcjell IAL-ve përkatëse numrat e matrikullimit të shtetasve të huaj brenda datës 3 dhjetor 2014.

7. Ngarkohen Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtorja e Integritit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla